

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**
Abteilung Volksschule

Gusht 2026

**Informacione për kalim prej kopshtit parashkollor (Kindergarten) në shkollën fillore të ulët
(Primarschule)**

Procedura e propozimit për kalim prej kopshtit parashkollor në shkollën fillore të ulët

Kalimi prej kopshtit parashkollor në shkollën fillore të ulët bëhet në bazë të propozimit nga personeli mësimor i kopshtit parashkollor. Kriteri kryesor për rekomandimin është zhvillimi i mëparshëm i fëmijës në lidhje me kompetencat e përshtuara në kurrikulën Aargau dhe parashikimin për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave. Biseda për kalim dhe propozimi i dhënë mbështetet në dosjen vlerësuese. Aty vë personeli mësimor i kopshtit parashkollor gjatë vitit shkollor shumë punime domethënëse të fëmijut (p.sh. punime individuale, vizatime, fotografitë e artizanatit, vetëvlerësimet e fëmijës etj.). I mbështetur në dokumente në dosjen vlerësuese sqaron dhe e arsyeton personeli mësimor i kopshtit parashkollor te prindërit propozimin për kalim.

Te propozimi për kalim në shkollën fillore të ulët personeli mësimor i kopshtit parashkollor e merr parasysh zhvillimin e fëmijut. Në raste të veçanta mund të jetë i nevojshëm kalimi në klasën e parë dy vjeçare (Einführungsklasse), në një ofertë të përshtatshme për fëmijë apo të rinjë me nevoja të posaçme shkollore apo një qëndrim në kopshtin parashkollor për një vit të tretë. Posaçërisht për këta fëmijë, të cilët gjatë vitit të parë të kopshtit parashkollor janë liruar nga obligimi i ndjekjes së kopshtit gjithsej për më shumë se gjysmë ditë, personeli mësimor i kopshtit parashkollor mund të propozojë përsëritjen e vitit të dytë të kopshtit parashkollor.

Procedura (ecuria)

Gjatë vitit të parë të kopshtit parashkollor mundet personeli mësimor i kopshtit parashkollor me prindërit sipas pyetësorit për vlerësim (Einschätzungsbogen) ta bëjë një bisedë për gjendjen e zhvillimit të fëmijut. Në vitin e dytë të kopshtit parashkollor personeli mësimor është i detyruar që ta zhvillojë një bisedë për kalim në kohën prej shkurtit deri në prill ku fëmija përfshihet duke marrë në konsideratë gjendjen e tij të zhvillimit. Përfshirja e fëmijës nuk do të thotë detyrimisht, që fëmija të marrë pjesë në bisedën e kalimit.

Personeli mësimor i kopshtit parashkollor dhe prindërit bëjnë marrveshjen me shkrim nëse janë dy palët të pajtimit me propozimin për kalim ose për qëndrim në kopshtin parashkollor për një vit tjetër shkollor. Nëse nuk ka marrveshje dhe diferencat nuk mund të kalohen me bisedat në vazhdim (prindër, fëmijë personeli mësimor i kopshtit parashkollor) vendos zyra kompetente e komunës¹ për kalim. Para këtij vendimi prindërit kanë mundësin, që t'i paraqesin argumentet e tyre zyrës kompetente (dëgjimi ligjor). Procedura e vendimit përfshirë ecurin se si ka ardhë deri te vendimi si edhe mundësin për ankesë ju dërgohet prindërve nga zyra përgjegjëse për vendimin brenda komunës me shkrim. Prindërit kanë mundësin kundër këtij vendimi mbrenda 30 ditësh nga pranimi i këtij vendimi të ankohen te Këshilli Rajonal i Shkollës (Schulrat des Bezirks).

¹ Këshilli i komunës mban përgjegjësinë e përgjithshme për shkollën. Me vendime zyrtare shkollore, si për shembull vendime aftësie, këshilli i komunës mund të ngarkojë një anëtar të këshillit ose drejtorinë e shkollës. Çdo komunë përcakton në një rregullore, çfarë zyre është kompetente për marrjen e vendimeve zyrtare shkollore.